

Titulli i projektit: Heritage is Our Brand

Zbatues: DMO Albania

Partner: EU Policy Hub/Forumi I Politikave të Integritimit

Kohëzgjatja e projektit: 24 muaj (14 Janar 2025-14 Janar 2027)

Thirrja: EuropeAid/180788/DD/ACT/AL, Lot 2: Kulturë dhe Art

Kontrata e Grantit: IPAIII/2024/460-837

Fondi: 338,255.79 euros

Nevoja për Ndërhyrje

Trashëgimia kulturore jo-materiale si: ritet, praktikat shpirtërore, gojëdhënat, gjuha, artizanati dhe traditat e transmetuara brez pas brezi – përfaqëson një pasuri të jashtëzakonshme për identitetin e një kombi. Në Shqipëri, këto pasuri janë duke u përballur me rrezik serioz zhdukjeje për shkak të modernizimit të shpejtë, mungesës së dokumentimit të qëndrueshëm dhe mos përfshirjes së brezave të rinj në procesin e njohjes së trashëgimisë kulturore.

Në këtë kuadër, projekti **“Heritage is Our Brand”** synon të adresojë sfidat kryesore që lidhen me ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e trashëgimisë jo-materiale përmes një ndërhyrjeje gjithëpërfshirëse, që fokusohet në edukim, pjesëmarrje rinore, fuqizim të shoqërisë civile, përdorimin e teknologjive të reja dhe nxitjen e partneriteteve institucionale.

Qëllimi i Projektit

Qëllimi kryesor i kësaj nisme është të angazhojë në mënyrë aktive brezat e rinj në procesin e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë, me fokus të veçantë në komponentin e trashëgimisë jo-materiale. Projekti synon që të rinjtë të mos jenë vetëm përfitues pasivë të kulturës, por aktorë të drejtpërdrejtë dhe bashkëkrijues në ruajtjen dhe rifunksionalizimin e saj në kontekstin modern. Përmes aktiviteteve edukative, artistike dhe teknologjike, brezat e rinj do të pajisen me njohuri, aftësi dhe mundësi konkrete për të ruajtur dhe rikrijuar lidhjen me identitetin kulturor kombëtar.

Objektivat Specifike

OS1. Zhvillimi i Modeleve Inovative:

Projekti synon të zhvillojë dhe pilotojë qasje bashkëkohore për promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë jo-materiale. Këto modele do të përfshijnë përdorimin e teknologjisë (si 3D, vizualizime digjitale, animacione, audio-tregime), metodat pjesëmarrëse me komunitetin, përfshirjen e artit bashkëkohor dhe qasje të reja në

edukim. Modelet e reja synojnë të sjellin një ndërveprim më të gjallë, më kreativ dhe më gjithëpërfshirës me trashëgiminë.

OS2. Rritja e Ndërgjegjësisë Publike:

Përmes një kombinimi të Hulumtimit skemës së nengranteve, eventeve edukative dhe zhvillimit të platformës Albania-Heritage.com, projekti do të kontribuojë në rritjen e vetëdijes qytetare mbi vlerën dhe rëndësinë e trashëgimisë jo-materiale. Ndërgjegjësimi do të fokusohet jo vetëm te rëndësia e ruajtjes, por edhe te potenciali i saj për zhvillim të qëndrueshëm, turizëm kulturor dhe forcim të identitetit kombëtar.

Përfituesit dhe Partnerët

Grupet përfituese përfshijnë:

- Organizatat e Shoqërisë Civile: përfitojnë nga ngritja e kapaciteteve, akses në fonde për ruajtjen e trashëgimisë jo materiale dhe rrjetëzim kombëtar.
- Të Rinj nga shkollat dhe universitetet: do të përfshihen në aktivitete edukative, konkurse krijuese, dhe platforma interaktive për të mësuar dhe kontribuar në trashëgiminë e komuniteteve të tyre.
- Artistë, historianë, studiues dhe artizanë: do të angazhohen në projekte bashkëpunuese me të rinjtë dhe do të kontribuojnë në dokumentimin dhe përpunimin artistik të elementeve të trashëgimisë jomateriale.
- Institucione publike (MEKI, MASR, shkolla, bashki): do të përfitojnë nga bashkëpunimi ndërsektorial për politika të reja kulturore dhe për përfshirjen e trashëgimisë jo materiale në edukim dhe zhvillim turistik.

Aktivitete

Projekti është i organizuar në 5 paketa pune që ndërtohen në mënyrë logjike:

I. Menaxhim dhe Koordinim i Projektit

Organizimi i strukturave drejtuese dhe teknike, aktiviteti fillestar (Launching Event), raportimet dhe sigurimi i zbatimit sipas standardeve të BE-së.

II. Hulumtim dhe Dokumentim i Trashëgimisë

- Vlerësim kombëtar mbi njohuritë dhe qëndrimet e të rinjve për trashëgiminë jomateriale
- Identifikimi dhe përpunimi i 15 tregimeve/traditave për t'u ruajtur përmes artit dhe teknologjisë.
- Tryezë kombëtare e aktorëve për të bashkërenduar prioritetet e sektorit.

III. Skema e Nën-Granteve për Vizualizimin e Trashëgimisë

- Financimi i 15 granteve të vogla bazuar në historitë e identifikuara të trashëgimisë sonë shpirtërore.

- Krijimi i tregimeve në formate bashkëkohore: video, animacione, 3D, performanca, art grafik etj.
- Mbështetje teknike, monitorim dhe vlerësim të granteve.

IV. Ndërhyrje Edukative

- Organizimi I Forum kombëtar me mësues dhe ekspertë historie.
- Zhvillimi I një Konkurs kombëtar ndërmje shkollave shkollor për përpunimin kreativ të trashëgimisë
- Organizimi I Eventit përmbyllës me prezantim të rezultateve të projektit dhe shpërndarje çmimesh.

V. Platforma Dixhitale dhe Komunikimi Publik

- Zhvillimi i ëëë.albania-heritage.com me përmbajtje edukative, kërkimore dhe ndërvepruese.
- Krijimi i identitetit vizual dhe fushatës së ndërgjegjësimit publik.
- Promovimi i sukseseve përmes mediave, rrjeteve sociale dhe publikimeve.

Pse ky projekt është i rëndësishëm?

Ky projekt adreson një boshllëk të qartë në politikat kulturore dhe edukative në Shqipëri. Në një kohë kur vendi synon integrimin evropian dhe po përballet me tendenca të forta globalizimi, është thelbësore të mbrojmë atë që na identifikon si komunitet dhe si komb.

Bashkëpunimi i institucioneve shtetërore me organizatat zbatues është jetik për:

- Integrimin e rezultateve në politikave kulturore, turizem dhe programet edukative.
- Shfrytëzimin e platformës Albanian-Heritage si mjet promovimi turistik dhe kulturor.
- Mbështetjen e zbatimit të Ligjit për Trashëgiminë dhe Strategjisë Kombëtare të Kulturës.
- Zgjerimin e qasjes në fondet e BE-së për zhvillim kulturor dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Qëndrueshmëria dhe Mundësitë për Replikim

Projekti është ndërtuar për të prodhuar rezultate afatgjata përmes:

- Platformës Albania-Heritage.al që do të përdoret pas përfundimit të projektit nga partnerët ose institucione publike.
- Dokumenteve të politikave dhe modeleve edukative që mund të integrohen në programet kombëtare.
- Skema e granteve është një model që mund të replikohet nga institucionet si një mundësi për të orientuar artistët, krijuesit etj...drejt nismave që mbështesin promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë jomateriale në vendin tonë.